

V E N D I M
Nr. 681, datë 20.12.2002

**PËR KRIJIMIN, SHTRIRJEN TERRITORIALE DHE KLASIFIKIMIN E ZONAVE
DOGANORE NË VENDKALIMET KUFITARE MURIQAN, BASHKIM VERMOSH DHE
TRI URAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 pika 3 të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e zonës doganore të përhershme në vendkalimet kufitare Muriqan dhe Bashkim Vermosh, në kufirin tokësor të Republikës së Shqipërisë me Republikën e Malit të Zi.
2. Krijimin e zonës doganore të përhershme në vendkalimin kufitar Tri Urat, në kufirin tokësor të Republikës së Shqipërisë me Republikën e Greqisë.
3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano